

**"ERJONI" SHPK**  
**RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË**  
**NIPT K11919002N**

---

**VENDIM**  
**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

**S**ot më datë 01.07.2019, ora 10:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Erjoni" sh.p.k të ndodhur në Rruga "Panorama", Kulla e Biznesit, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë "Erjoni" sh.p.k, një shoqëri e regjistruar më 04.01.1995, me NUIS K11919002N (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Në mbledhje është i pranishëm ortaku:

1. Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të kuotave të shoqërisë "Erjoni" sh.p.k.

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se është i pranishëm ortaku që përfaqëson shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

- 1. Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Erjoni" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;**
- 2. Dhënien e miratimit për kalimin e fitimit të vitit 2018 në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital.**
- 3. Të ndryshme**

Ortaku prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar).

Për sa më sipër:

**ASAMBLEJA E SHOQËRISË**

**VENDOSI:**



**"ERJONI" SHPK**  
**RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË**  
**NIPT K11919002N**

---

- 1. Të japë miratimin për raportin e veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar z. Agim Qenani lindur në Korçë, e banues në Elbasan, pajisur me Liçensë Nr.53, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Erjoni" sh.p.k. për bilancin ushtrimor të vitit 2018;**
- 2. Të japë miratimin për kalimin e fitimit në kapitalin themeltar të shoqërisë duke e rritur këtë kapital nëpërmjet përfshirjes së fitimit të vitit ushtrimor 2018;**
- 3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë, z. Klodi Ajazaj, të depozitojë personalisht apo nëpërmjet një personi te autorizuar këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (Q.K.B) për efekt të regjistrimit të tij.**

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

**Z.IRFAN HYSENBELLIU**

